



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:225112

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05418361

C.nr.522/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr.Zh nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson me autorizim Av. M.S nga Prishtina, rruga ..., kundër të paditurës K...me seli në Prishtinë, rruga ..., me objekt kontesti Kompensim dëmi, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia C.nr.522/17 e datës 31.10.2017, e paditësit Rr.Zh nga Vushtrria, kundër të paditurës K...me seli në Prishtinë, rruga ..., me objekt kontesti Kompensim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësi Rr.Zh nga Vushtrria, me datë 31.10.2017, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës K...me seli në Prishtinë, rruga

Në seancën përgatitore të mbajtur me datë 06.03.2024, nuk ka prezantuar i autorizuari i paditësit dhe mungesën nuk e ka arsyetuar edhe përkundër thirrjes së rregullt siç konstatohet nga fletëkthesa e datës 16.02.2024, po ashtu nuk ka prezantuar e paditura K..., përkundër thirrjes së rregullt siç konstatohet nga fletëkthesa e datës 16.02.2024.

Marrë parasysh faktin se përkundër ftesës me rregull në seancë nuk ka prezantuar përfaqësuesi i paditësit Rr.Zh dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë kundër të paditurës.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.522/17, me datë 06.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.